

Buxheti me pjesëmarrje në nivel vendor është gjithashtu thelbësor për krijimin e besueshmërisë mes pushtetit vendor dhe qytetarëve. Kur ju pyeteni për mendimet dhe opinionet tuaja, kur ajo çfarë thoni merret parasysh, si dhe kur ju shihni rezultatin e diskutimit tuaj në përbërjen e buxhetit të qytetarëve, besimi juaj për qeverisjen vendore do të rritet. Kjo, në këmbim, do t'ju shtyjë të jeni më të hapur për atë çka doni dhe ju duhet, gjë e cila do çojë në një dialog më të sqartë dhe të qëndrueshëm mes jush dhe pushtetit tuaj vendor, duke rritur edhe ndërgjegjen qytetare tek çdo individ pjesëmarrës.

Kjo sigurisht do mundësojë që të kuptoni më mirë se çdo shërbim i ofruar nga bashkia kërkon para, **ndaj ju si qytetarë të zakonshëm, ashtu si edhe bizneset lokale keni detyrimin të PAGUANI TAKSAT.**

Përse duhen paguar taksat? Buxheti i bashkisë suaj përbëhet edhe nga paratë që ju paguani, ndaj sa më të rregullt jeni si taksapagues, aq më shumë para qyteti juaj do ketë për t'ju ofruar shërbime cilësore shtesë.



BUXHETI ME PJESËMARRJE MUND TË SJELLË PËRFITIMET E MËPOSHTME PËR QYTETARËT:

- të përmirësojë përgjegjshmërinë dhe transparencën e qeverisjes vendore duke e bërë publik procesin e buxhetimit dhe duke ulur korrupsionin;
- të inkurajojë qytetarët për t'u përfshirë më tepër në çështjet e komunitetit të tyre dhe të kenë kontribut direkt në procesin e vendimmarrjes lokale;
- të rrisë njohuritë e qytetarëve mbi rolet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të qeverisë vendore;
- të rrisë vetëbesimin e individëve apo organizatave në trajtimin e problemeve të zonave të tyre të banimit dhe në kryerjen e negociatave me organizatat e sektorit publik;
- të ndihmojë qytetarët për të kuptuar limitet e qeverisjes vendore, kostot e projekteve publike dhe natyrën e kompromiseve të nevojshme për realizimin e prioriteteve;
- të rrisë drejtësinë sociale duke ofruar një platformë për anëtarët tradicionalisht të përjashtuar të shoqërisë që të kenë një zë në proceset vendimmarrëse, potencialisht duke sjellë në një qeverisje më të drejtë dhe të barabartë,
- të përmirësojë kushtet e jetesës për më të varfrit;
- të influencojë për prioritizimin më efikas të shpenzimeve buxhetore të bashkisë, duke iu përgjigjur nevojave të qytetarëve;
- të fuqizojë barazinë gjinore.

Në rast se ju duhet më shumë informacion mbi buxhetin me pjesëmarrje dhe procesin e tij, ju lutem vizitoni faqen zyrtare të bashkisë tuaj, ose vizitoni: <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

"Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e projektit Bashkitë për në Evropë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian"



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

DEMOKRACIA VENDORE

BUXHETIMI ME PJESËMARRJE: ANGAZHOSHU PËR QYTETIN TËND

Qeveria vendore është përgjegjëse ndaj qytetarëve të saj për çfarë bën dhe si e bën atë. Përgjegjësi do të thotë, pjesërisht, që politikat dhe planet që zhvillon qeverisja vendore duhet të reflektojnë prioritetet dhe nevojat e qytetarëve. Ajo gjithashtu nënkupton se NjQV-ja (njësia e qeverisjes vendore) duhet të japë llogari lidhur me çfarë ka bërë për implementimin e atyre politikave dhe planeve, së bashku me rezultatet e përpjekjeve të saj. Qytetarët, nga ana e tyre, kanë përgjegjësi kërkesën e llogarisë ndaj pushtetit vendor. Ata duhet të bëhen pjesëmarrës aktiv në jetën publike, të votojnë për ata tek të cilët besojnë, të monitorojnë lëvizjet e pushtetit vendor, të komentojnë politikat dhe planet e tij, si dhe ta sfidojnë atë kur gjerat shkojnë keq.

Ju si qytetarë duhet të dini se procesi i konsultimeve publike mund të nxisë përmirësime për një qeverisje më të mirë në nivel vendor dhe gjithashtu të rrisë zotërimin e programeve.

Sipas legjislacionit në fuqi, ç'do bashki në Shqipëri duhet të ndër marrë konsultime me qytetarët në mënyrë që të diskutojë për buxhetin e vitit të ardhshëm dhe planin strategjik afatmesëm të bashkive. Konsultimet publike ndodhin në çdo bashki gjatë muajve Shtator – Nëntor të çdo viti. Ju lutem vizitoni vazhdimisht faqet zyrtare online të bashkisë tuaj gjatë kësaj periudhe, ashtu si edhe faqet përkatëse në rrjetet sociale, në mënyrë që të informoheni për kohën dhe vendndodhjen e konsultimeve publike që do të mbahen në qytetin tuaj.



PSE DUHET NJËSIA E PUSHTETIT VENDOR TË KRIJOJË NJË BUXHET TË QYTETARËVE?

Ju keni të drejtë të dini se paratë e pushtetit vendor janë paratë e qytetarëve të tij, pra janë paratë tuaja. Të ardhurat, pushteti vendor i mbledh nga ju në formë taksash (fitimi, shitjet apo pronat), tatimesh, si dhe nga shfrytëzimi i resurseve natyrore që ju përkasin ju.

KUSH PËRFITON NGA NJË BUXHET QYTETARËSH?

Ju jeni, sigurisht, përfituesit e parë të Buxhetit të Qytetarëve. Vetë qëllimi i një buxheti të tillë është rritja e njohurive tuaja mbi atë çfarë po bën pushteti vendor, si dhe shtimi i kapaciteteve që keni për t'u bërë pjesë në çështjet e qeverisjes së njësisë suaj vendore.

ÇFARË ËSHTË BUXHETI I QYTETARËVE?

- Përpilohet nga qeveria vendore;
- ***Bëhet në konsultim me qytetarët si buxhetim me pjesëmarrje;***
- Mundëson njohje dhe përvetësim publik të buxhetit;
- Shërben si “dritare” për më shumë informacion lidhur me buxhetin;
- Fokusohet mbi dokumentet e planifikimit buxhetor;
- Publikohet njëkohësisht ose pothuajse në të njëjtën kohë me vetë buxhetin;
- Përfshin informacion të bollshëm lidhur me buxhetin;
- Përgatitet në gjuhën zyrtare ; dhe me informacion konkret në mënyrë që qytetarët ta kuptojnë sa më thjeshtë ku do të shpenzohen paratë e tyre.

PROCESI I KRIJIMIT TË NJË BUXHETI PËR QYTETARËT

Rëndësia e konsultimeve

Si përdoret dokumenti i Buxhetit të Qytetarëve? Më e mira është të merret dokumenti kur publikohet nga Bashkia juaj, të lexohet e të reflektohet mbi të dhe informacioni i dokumentit të përdoret për të bërë pyetje mbi si bashkia juaj po i mbledh dhe i shpenzon fondet e saja. Në rast se ju nuk keni mjaftueshëm kohë për këtë gjë, ju lutem merrni pjesë në diskutimet publike të organizuara nga bashkia juaj dhe bëni gjithë pyetjet e nevojshme mbi shqetësimet që ju keni në lidhje me qytetin tuaj, si qytetarë apo si sipërmarrës vendor.

Por fillimisht, ju duhet të dini se hapi i parë në zhvillimin e një Buxheti për Qytetarët në pushtetin vendor duhet të jetë konsultimi me ju. Diskutimi i buxhetit me vetë komunitetet është **DETYRIM** për secilën njësi të qeverisjes vendore dhe jo një **DËSHIRË**, prandaj ju lutemi të merrni pjesë në këtë proces dhe të pyesni bashkinë tuaj mbi buxhetin e saj.

